

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren “UKSHIN HOTI”	
Pranuar me dt. 25.05.2015	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-184/A



UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI”

UNIVERSITY “UKSHIN HOTI”

Në Prizren

Rektorati

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Rektor
Prof. Dr. Ramë Vataj

Nr. i ref. 01- _____

Prizren, më 22.5.2015

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË STUDIMEVE
MASTER

Prizren, 2015

Mbështetur në dispozitat e nenit 88 të Statutit të Universitetit të Prizrenit nr.04 -V- 621 dt.30 maj 2013 Senati i UPZ-së, në mbledhjen e mbajtur më 22.5.2015 nxjerr këtë:

Rregullore për studimet e masterit

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me **Rregulloren e studimeve të masterit** (në tekstin e mëtejshëm- *Rregullore*) përcaktohen: Mënyrat e organizimit të studimeve dhe llojet e tyre; kushtet për t'u regjistruar në studime; provimet dhe suksesi i tyre, si dhe organizimi përfundimtar i studimeve, pra deri në përgatitjen e punimit të diplomës së masterit.

Organizimi dhe llojet e studimeve

Neni 2

Në Universitetin "Ukshin Hoti" të Prizrenit organizohen studimet të rregullta të masterit. Universiteti mund të organizon studime të masterit në bashkëpunim me universitetet dhe fakultetet të tjera përkatëse, kryesisht brenda kampusit, por organizon edhe në bashkëpunim me fakultetet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Për këtë qëllim mund të ofrojë programe dy lëndore dhe programe ndërdisiplinore të studimeve.

Neni 3

Studimet e masterit kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë studentët, të cilët i kanë kryer studimet themelore (baçelor) dhe kanë fituar së paku 180 kredi.

Në studimet e masterit kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatët, të cilët studimet themelore i kanë kryer jashtë vendit që njihen nga EUA (Shoqata e Universiteteve Evropiane) ose institucionet që janë të pranuar nga një agjenci ndërkombëtare e akreditimit.

Barasvlerësimin e certifikatave- diplomave të jashtme e bën Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse.

Studentët të cilët në studimet baçelor kanë arritur notën mesatare 8.0 e më tepër, mund të regjistrohen drejtpërdrejt në studimet e masterit dhe përparësi kanë studentët që kanë studiuar në Universitetin e Prizrenit.

Përzgjedhja e kandidatëve deri të numri i paraparë me konkurs bëhet sipas ranglistës prioritare të notës mesatare të arritur gjatë studimeve baçellor.

Studentët që kanë studiuar në universitete dhe kolegje të tjera shtetërore apo private, ata pavarësisht notës mesatare do të seleksionohen pasi që janë përzgjedhur kandidatët që kanë studiuar në UPZ dhe që i kanë plotësuar kriteret e parapara.

Në rastet kur numri i kandidatëve të paraqitur është më i vogël se numri i shpallur me konkurs, atëherë mund të pranohen edhe studentë me notë mesatare nën 7.5 por ata do t'i nënshtrohen provimit kualifikues, mbi bazën e kriterëve, të cilat i përcakton Fakulteti përkatës.

Neni 4

Të drejtën e dhënies së mësimit në master e kanë personeli mësimor me thirrje të profesorit (*profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent*), të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me Statutin e Universitetit të Prizrenit.

Të drejtën e mbajtjes së ushtrimeve, seminareve në studimet e masterit e kanë edhe asistentët, të cilët me së paku e kanë titullin shkencor magjistër ose diplomë ekuivalente me atë.

Në raste të caktuara në një lëndë mësimore mund ta mbajnë dhe organizojnë mësimin (me një plan-program) dy ose më shumë mësimdhënës. Në rast kur mësimin e mbajnë më shumë mësimdhënës (me një plan-program) në indeks shënohet emri i bartësit të lëndës.

Neni 5

Në UPZ, të drejtën e organizimit të studimeve master e kanë këto fakultete:

1. Fakulteti i Edukimit,
2. Fakulteti i Juridikut,
3. Fakulteti i Ekonomisë,
4. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike,
5. Fakulteti i Filologjisë.

Neni 6

Studimet e masterit i udhëheq Dekani i Fakultet përkatës. Listën e mësimdhënësve të propozuar nga Fakultetet për realizimin e programit në studime master e aprovon Rektori dhe Senati i Universitetit të Prizrenit.

Neni 7

Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teorike, punës praktike, punës në terren, ekskursioneve profesionale dhe shkencore-mësimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmes punimeve të pavarura të studenteve. Studimet masterit përfundojnë kur studenti mbron publikisht temën e masterit dhe arrin thirrjen shkencore master i shkencave të profilit të caktuar.

Neni 8 (Kushtet e regjistrimit në studime)

Universiteti i Prizrenit, regjistron studentë sipas mundësive kadrovike e teknike, të nevojave të shoqërisë dhe tregut. Propozimin për regjistrimin e studentëve të rinj e jep Fakulteti përkatës dhe e miraton Senati i Universitetit të Prizrenit.

Vendimin përfundimtar për shpalljen e konkursit publik e bën Senati i Universitetit të Prizrenit.

Neni 9

Përzgjedhja e kandidatëve sipas nenit 3 (*tre*) të kësaj Rregulloreje e bën Komisioni përkatës më së paku 3 anëtarë, të cilët janë të zgjedhur nga Dekani i Fakultetit. Komisioni duhet të jetë kompetent dhe profesional sipas lëmisë së studimeve.

Komisioni në bashkëpunim me Dekanin e Fakultetit e shpall ranglistën e kandidatëve që kanë aplikuar. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në studimet master mund të ushtrojnë ankesë me shkrim në Senat brenda dy ditëve të punës pas publikimit të rezultateve. Vendimi për kërkesat e ushtruara merren në afatin prej dy ditë pune pas ushtrimit të ankesës.

Neni 10

Regjistrimi i studentëve në semestrin e parë në studimet master bëhet në Administratën e Universitetit të Prizrenit, kurse ID kartelën e studentit e nënshkruan Sekretari i përgjithshëm i Universitetit të Prizrenit.

Neni 11

Me rastin e konkurrimit kandidatët duhet të sjellin këto dokumente:

- ✓ Certifikatën e ditëlindjes;
- ✓ Diplomën origjinale (*certifikatën*) e kryerjes së fakultetit;
- ✓ Për studentët që kanë studiuar jashtë vendi, kërkohet edhe vendimin për njohjen e diplomës;

Kandidatët e pranuar për regjistrim paraqesin:

- ✓ Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit;
- ✓ Tri fotografi (*formati 4,5 x 6cm*);
- ✓ Pagesën në lartësi të përcaktuar nga Universiteti i Prizrenit.

Dokumentet e dorëzuara nga studenti me rastin e regjistrimit mbeten në shërbimin e studenteve. Shërbimi i studentëve bën regjistrimin e studentëve të rinj në librin amzë, në programin e veçantë në kompjuter dhe formon dosjen e studentit.

Studentët që nuk ju përgjigjen datave të planifikuara për regjistrim, ata e humbin të drejtën e regjistrimit.

Neni 12 (Ndërrimi i programit dhe transferimi nga Universitetet e tjera)

Për ndërrimin e programit të studimit ose transferimit nga Universitetet e tjera publike vendore dhe ndërkombëtare, vlejné dispozitat e parapara me Statutin e Universitetit të Prizrenit dhe me rregulloret e brendshme të fakulteteve.

Neni 13 (Kohëzgjatja e studimeve)

Studimet e masterit zgjasin 2 vjet, katër semestra dhe në çdo semestër me dhënien e provimeve fitohen nga 30 ECTS, që do të thotë se për përfundimin e këtyre studimeve duhet të arrihen 120 kredi të ECTS. Studenti me kushte të përcaktuara me Statutin e UPZ-së e ruan statusin e studentit të rregullt edhe për dy vite të tjera.

Fillimi dhe mbarimi i semestrave mësimor bëhet sipas dispozitave të Statutit të Universitetit të Prizrenit. Mësimi në studimet master zhvillohet në 15 javë për një semestër.

Neni 14 (Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit)

Personi i regjistruar në Universitetin e Prizrenit e ka statusin e studentit të rregullt. Statusi i studentit dëshmohet me ID kartelën e studentit, në rast të humbjes së ID kartelës me lejen e Dekanit të Fakultetit, studentit mund të ju sigurohet ID kartela e re.

Kërkesës për indeks, ID kartele te re duhet t'i bashkëngjitet dëshmia se dokumenti është shpallur i pavlefshëm dhe se është bërë pagesa sipas rregullores.

Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit do të rregullohen me Statutin e Universitetit të Prizrenit dhe me rregulloret e brendshme të fakulteteve.

Komisioni disiplinor i Universitetit të Prizrenit i përjashton nga Fakulteti përkohësisht ose përgjithmonë studentët, të cilët i shkelin rregullat e përcaktuara me Rregulloren për procedurën disiplinore të Universitetit të Prizrenit.

Humbja e statusit të studentit do të rregullohet me Statutin e Universitetit të Prizrenit.

Neni 15 (Të drejtat dhe obligimet e studentëve)

Të drejtat dhe obligimet e studentëve do të përcaktohet me Statutin e Universitetit të Prizrenit dhe vlejné edhe për studentët e studimeve master.

Neni 16

Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore të studentëve rregullohet me Rregulloren për procedurën disiplinore të Universitetit të Prizrenit.

Neni 17

Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të shqiptuar nga organet e Fakultetit që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre. Ankesat e tilla i dorëzohen Senatit të Universitetit të Prizrenit, brenda 8 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit. Senati i UPZ-së, brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës, merr vendimin përfundimtar.

Neni 18 (Kushtet e regjistrimit të vitit)

Senati i Universitetit të Prizrenit me vendim të veçantë, përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studentëve.

Neni 19 (Provimet dhe suksemi në provime)

Studentët janë të obliguar dhe kanë të drejtë të paraqesin dhe t'i marrin provime. Provimet merren nga të gjitha lëndët e parapara me planin e studimeve, pas përfundimit të mësimit të lëndëve përkatëse.

Studenti fiton të drejtën për të ju nënshtruar provimeve nga lënda pasi t'i kryen obligimet që parashihen me programin mësimor. Provimet mbahet me shkrim, me gojë ose me shkrim dhe me gojë. Kur provimi përbëhet prej pjesës me shkrim dhe me gojë, studentit mund të hyjë në provim me gojë, vetëm atëherë kur në pjesën me shkrim ka marrë notën pozitive.

Për përcaktimin e suksesit akademik të studentit, mund të aplikohen edhe format e punës, si: Testet, punimi i seminarit, testi dhe ushtrimet praktike.

Neni 20

Provimet në studimet e masterit mbahen gjatë vitit akademik sipas afateve të lejuara me Statutin e UPZ-së dhe me udhëzimet e Senatit.

Neni 21

Suksemi i studentit në provim shprehet me notën 5 (*pesë*) deri në 10 (*dhjetë*).

Nota shënohet me numër dhe me tekst në procesverbalin, të cilin pedagogu e pranon nga SEMS-si. Fletëparaqitjet dhe procesverbali i provimit i dërgohen referentit, i cili më së voni 3 ditë pas mbajtjes së konsultimeve dhe vendosjes së notave në SEMS, shërbimi i studentëve i regjistron notat në librin amzë dhe në dosjen e studentit.

Provimet janë publike dhe shpallen në tabelën e shpalljeve në departamentet përkatëse.

Neni 22

Për studentët të cilët nuk janë të kënaqur me vlerësimin dhe notën e marrë në provim, do të vlejnjë dispozitat e Statutit të UPZ-së.

Neni 23 (Punimi i diplomës– teza për master)

Studimet e masterit në Universitetin e Prizrenit përfundojnë me mbrojtjen e punimit të masterit, në pajtim me programin e studimeve.

Studenti i cili i ka kryer obligimet e parapara me planin dhe programin mësimor të studimit përkatës, fiton të drejtën të marrë temën e masterit.

Studenti mund të paraqes temën e masterit me minus 2 provime.

Neni 24

Mësimdhënësit të cilët marrin pjesë në mbajtjen e mësimit në studimet e masterit, gjatë vitit akademik i propozojnë Këshillit të Fakultetit (*përmes Dekanit*) deri në 5 tituj të ndryshëm të temave për punimin e masterit me arsyetim përkatës për drejtim.

Mësimdhënësi që ka propozuar temën është mentor potencial i asaj temës.

Neni 25

Punimi për master hulumtohet individualisht nga studentin duke vërtetuar se aftësitë teorike dhe praktike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve kërkimore në fushën shkencore kërkimore për të cilën është përcaktuar studentin.

Neni 26

Propozimi me shkrim për lejimin e temave për punimin e masterit duhet të përmbajë: Titullin me arsyetimin e temës së propozuar, qëllimin shkencor të punimit, tezat themelore që do të merren për bazë dhe instrumentet që do të zbatohen në realizimin e hulumtimit.

Neni 27

Këshilli i Fakultetit miraton titullin e propozuar dhe lejon hartimin e punimit të masterit. Me këtë rast Dekani në koordinim me Këshillin mësimorë shkencor të Fakultetit emëron mentorin, i cili e udhëheq studentin gjatë punës në temën e punimit të diplomës– tezës për master.

Neni 28

Tema e masterit, paraqet punim të pavarur profesional të kandidatit me të cilin tregon që ka përvetësuar njohuritë teorike dhe praktike dhe mund të parashtrojë dhe zgjidhë probleme dhe detyra profesionale– shkencore.

Neni 29

Pjesa e mikrotezës për diplomën “master i shkencave” duhet të ketë prej 50-80 faqe të formatit A4. Referencat shënimet në fund të faqes nuk përfshihen në këtë përlllogaritje. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë fushën kërkimore- shkencore sipas programit që ai ka shlyer në

programin përkatës. Lloji i shkrimit në "Times New Roman"; madhësia e shkronjave në tekst duhet të jetë 12; hapësira midis rreshtave (space line) duhet të jetë 1.5.

Neni 30

Punimi dorëzohet në **8 (tetë)** kopje në lidhje të fortë në administratën e njësisë akademike ku studion kandidati **30 ditë** para datës së mbrojtjes së punimit të masterit.

Neni 31

Kandidati në afat prej më së shumti një viti pas vërtetimit të semestrit të katër të studimeve master duhet të dorëzojë punimin e përfunduar me shkrim të diplomës për vlerësim.

Me kërkesë të kandidatit, Dekani i Fakultetit mund të cakton një afat të ri më së shumti deri në 6 (*gjashtë*) muaj për të dorëzuar punimin e diplomës- masterit.

Arsyet për shtyrjen e afatit e vlerëson Këshilli i Fakultetit përkatës.

Në qoftë se kandidati nuk e dorëzon punimin e përfunduar të diplomës- masterit për vlerësim në afatin e caktuar me këtë nen, kandidati duhet ta rifillojë procedurën për lejimin e punimit të diplomës me temë të re, përkatësisht ta rikthej statusin e studentit të rregullt në pajtim me Statutin e UPZ-së.

Neni 32

Pas dorëzimit të punimit të përfunduar të diplomës për vlerësim Dekani i Fakultetit, me propozim të Këshillit të Fakultetit përkatës, ngrit komisionin për vlerësimin e punimit të masterit në afatin prej 30 ditësh prej ditës të paraqitjes të kërkesës të kandidatit.

Detyrë e komisionit është që pas shikimit të punimit, t'i paraqet raport me shkrim përmes Dekanit, Këshillit të Fakultetit në afat jo më të gjatë se 3 (tre) muaj. Komisioni për vlerësim të punimit të diplomës- master, me shumicë të anëtarëve të vetë, i propozon Këshillit që punimi të miratohet dhe kandidatit t'i lejohet mbrojtja, ose punimi të plotësohet apo punimi të refuzohet.

Anëtari i komisionit i cili nuk pajtohet me propozimin nga alineja paraprake të këtij neni është i detyruar që mendimin ta ndaj dhe ta paraqet në formë të shkruar.

Neni 33

Komisioni për vlerësimin e punimit të diplomës- master përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve, prej të cilëve njëri është oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij për punimin.

Sipas nevojës, Dekani i Fakultetit mund të formojë komisionin prej 5 (pesë) anëtarësh. Anëtar të komisionit mund të jenë mësimdhënësit në thirrje të profesorit (profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent).

Neni 34

Komisioni i vlerësimit të temave të diplomave përbëhet nga 3 (tre) anëtarëve (pedagogë)

Neni 35

Në bazë të propozimit të komisionit vlerësues, Dekani i Fakultetit merr vendim për lejimin e mbrojtjes publike të punimit master.

Komisioni për mbrojtje formohet në përbërje të përcaktuar me nenin 32 të kësaj Rregulloreje. Mentori nuk mund të jetë kryetar i komisionit për mbrojtjen publike të punimit master.

Neni 36

Në qoftë se punimi i kandidatit refuzohet nga komisioni përkatës ose kandidati për shkaqe të tjera nuk e bën plotësimin e punimit në afatin sipas nenit paraprak, kandidati ka të drejtë që të paraqet propozimin me shkrim për titullin e ri të punimit të masterit. Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzojë vetëm një herë.

Neni 37

Në qoftë se Këshilli i Fakultetit ia kthen kandidatit punimin për ta plotësuar, me atë rast mundet ta zgjerojë komisionin për vlerësimin e punimit të plotësuar.

Kandidati duhet ta bëjë plotësimin e punimit të masterit në afatin më së largu gjashtë muaj.

Kur Komisioni pranon punimin e plotësuar, është i obliguar që të harton raport të ri për vlerësimin e punimit dhe të njëjtin t'ia dërgo të Dekanit në afat prej 30 ditësh, prej ditës kur e ka pranuar punimin.

Neni 38

Punimi i masterit i vlerësuar pozitivisht nga anëtarët e komisionit, në afatin prej 15 ditësh mbetet në diskutim publik së bashku me raportet e komisionit vlerësues në sekretarinë e Fakultetit.

Gjatë diskutimit publik, punimi jepet në dispozicion që të shikohet nga të interesuarit të cilët mund të japin vërejtje dhe sugjerime eventuale.

Neni 39

Këshilli i Fakultetit përkatës pas kalimit të afatit nga neni paraprak dhe miratimit të raportit të komisionit mbi vlerësimin pozitiv të punimit të masterit, e formon komisionin për mbrojtjen publike të punimit masterit. Komisioni në marrëveshje me kandidatin e cakton datën dhe vendin (sallën) e mbrojtjes publike të punimit.

Mbrojtja publike e punimit master duhet të bëhet brenda afatit, i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se 7 ditë dhe as më i gjatë se 30 ditë prej ditës së nxjerrjes së vendimit

Neni 40

Sekretari i Fakultetit bënë lajmërimin për mbrojtjen e punimit të masterit 7 ditë para ditës së mbrojtjes. Lajmërimi jepet në tabelën e shpalljeve të Fakultetit, dhe në Web faqen e UPZ-së.

Në lajmërim paraqiten të dhënat për kandidatin, **Komisioni për mbrojtje**, titulli i punimit dhe informatën se mbrojtja është publike.

Neni 41 (Procedura e mbrojtjes)

Kryetari i komisionit e hapë seancën për mbrojtjen publike të punimit të masterit, paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e vendimit mbi lejimin e mbrojtjes të punimit si dhe paraqet të dhënat biografike dhe bibliografike të kandidatit.

Mentori në pika të shkurtra e paraqet raportin e vlerësimit të punimit para komisionit dhe audiencës për vlerësimin e punimit të masterit. Kandidati bënë një prezantim– paraqitje të përmbledhur të punimit, por jo më gjatë se 30 minuta.

Anëtarët e komisionit përmes pyetjeve që ia shtrojnë kandidatit dhe përgjigjeve të tij, e bëjnë verifikimin e autorësisë të punimit dhe vlerësojnë nivelin e njohjes së problematikës që trajtohet në punim.

Neni 42

Kryetari i komisionit e bënë përfundimin e mbrojtjes dhe fiton komisionin që të vendos për të bërë vlerësimin dhe marrë vendimin përfundimtar për shpallje te rezultatit te mbrojtjes publike.

Vendimi i komisionit shpallet publikisht para auditorit.

Neni 43

Kandidati ka mbrojtur punimin e masterit nëse shumica e anëtarëve të komisionit kanë dhënë vlerësimin pozitiv për mbrojtjen e punimit. Punimi vlerësohet me note prej 6-10. Nota e punimit mund të jetë për 2 nota më e lartë se nota mesatare. Nëse kandidati nuk e ka mbrojtur me sukses punimin e masterit, ai mund të paraqet propozim të ri të punimit të masterit brenda 6 (gjashtë) muajve prej ditës së njoftimit se nuk e ka mbrojtur publikisht punimin e masterit.

Neni 44

Pas përfundimit të studimeve dhe mbrojtjes me sukses të punimit të masterit, kandidati fiton thirrjen shkencore “master shkencor në fushës përkatëse”.

Pas fitimit të thirrjes shkencore “master shkencor”, kandidati nga shërbimet përkatëse të Universitetit të Prizrenit pranon certifikatën dhe diplomën e nënshkruar nga Dekani dhe Rektori. Fakulteti dhe Universiteti mbajnë evidencën e studentëve të diplomuar në studimet master.

Neni 45

Kandidatit për thirrjen e masterit shkencor mund t'i kontestohet dhe t'i merret nëse konstatohet se punimi i masterit është plagjiat ose është ndonjë forme falsifikimi.

Në rast të dyshimit të bazuar, Dekani i Fakultetit formon komisionin prej tre anëtarëve që të shqyrtoj dyshimet e paraqitura lidhur me punimin e masterit.

Këshilli i Fakultetit e shqyrton raportin e komisionit dhe nëse konstaton dyshimet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, i propozon Senatit të UPZ-së marrjen e thirrjes së masterit.

Senati i Universitetit të Prizrenit e merr vendimin përfundimtar për marrjen e thirrjes së masterit.

Neni 46 (Dispozitat kalimtare)

Rregullorja miratohet nga Senati i Universitetit të Prizrenit. Për të gjitha çështjet tjera mbi të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit të UPZ-së dhe Ligji mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

Rregullorja hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kryetari i Senatit të Universitetit të Prizrenit. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje mund të bëhen sipas procedurës me të cilën është miratuar.

Shtojca nga faqe 12-25 është model i një punimi të diplomës se masterit.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Kryetari i Senatit të UPZ-së
Prof. Dr. Ramë VATAJ